



Ministria e Bujqesise, Ushqimit
dhe Mbrojtjes se Konsumatorit



Manual mbi disa procedura teknike qe duhet te ndiqen nga Pikat e Inspektimit Kufitar gjate importimit te kafsheve te gjalla dhe produkteve shtazore ne Shqiperi

BOTIMI I DYTE

Tabela e Permbajtjes

HYRJA	FAQE	4
PERKUFIZIME	FAQE	4
<u>KAPITULLI I</u>	KONTROLLET VETERINARE AKTUALE (PRODUKTE SHTAZORE DHE KAFSHE TE GJALLA)	
	FAQE	7
1. LEGJISLACIONI	FAQE	7
1.1 LEGJISLACIONI AKTUAL KOMBETAR	FAQE	7
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	7
2. PROCEDURAT PER KONTROLLET VETERINARE	FAQE	8
2.1 KONTROLLET E DUHURA	FAQE	8
2.2 PRODUKTET PER TU KONTROLLUAR	FAQE	8
2.3 NJOFTIMI I MBERRITJES DHE PREZANTIMI I KERKESAVE	FAQE	9
3. DOKUMENTACIONI I P.I.K.-ut.	FAQE	9
3.1 DOKUMENTAT QE DUHET TE MBAHEN	FAQE	9
3.2 PERGJEGJESITE E SHVZ TE PIK-UT	FAQE	10
4. KONTROLLET POLICI-NGARKESE (E LISTES SE PRODUKTEVE/ MALLRAVE)	FAQE	11
5. KONTROLL I LISTES	FAQE	11
<u>KAPITULLI II</u>	KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE	
	FAQE	13
1. HAPESIRA LIGJORE	FAQE	13
1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR	FAQE	13
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	13
2. MBERRITJA	FAQE	13
2.1 PARAQITJA E INFORMACIONIT PERKATES NE PIK (PIKA INSPEKTIMIT KUFITAR)	FAQE	13
2.2 KONTROLLI I DVIT	FAQE	14
2.3 PROCEDURAT E ZAKONSHME PER KONTROLLET E DOKUMENTACIONIT TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE NGA VENDET E TRETA.	FAQE	14
2.4 PERJASHTIME DHE SHMANGIE	FAQE	14
<u>KAPITULLI III</u>	KONTROLLI I IDENTITETIT TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE	
	FAQE	17
1. HAPESIRAT LIGJORE	FAQE	17
1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR	FAQE	17
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	17
2. PROÇEDURAT	FAQE	17
2.1 PROCEDURA E KONTROLLIT TE IDENTITETIT	FAQE	17
2.2 RASTET SPECIFIKE	FAQE	18
<u>KAPITULLI IV</u>	KONTROLLI FIZIK I PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE	
	FAQE	20
1. HAPESIRA LIGJORE	FAQE	20
1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR	FAQE	20
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	20
2. CESHTJET MBESHTETESE	FAQE	21

3. PROCEDURAT	FAQE	21
3.1 SISTEMI I KONTROLLEVE TE REDUKTUARA: PERCAKTIMI PER KONTROLLET FIZIKE.	FAQE	21
3.2 PERCAKTIMI I MOSTRAVE	FAQE	21
3.3 MARRJA E MOSTRAVE PER KONTROLLET FIZIKE	FAQE	21
3.4 KRYERJA E KONTROLLIT FIZIK	FAQE	22
3.5 TESTET LABORATORIKE TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE	FAQE	23
3.6 MARRJA E MOSTRAVE	FAQE	23
3.6.1 Rregjistrimi i mostrave dhe plotesimi i dokumentit shoqerues	FAQE	24
3.6.2 Paketimi dhe Identifikimi	FAQE	24
3.6.3 Transporti	FAQE	24
3.6.4 Perpunimi i rezultateve te ekzaminimit laboratorik.	FAQE	24
3.6.5 Mbyllja e pakove dhe konteniereve te hapur, trajtimi i mostrave pas ekzaminimit.	FAQE	25
<u>KAPITULLI V</u> MARRJA E MOSTRAVE	FAQE	26
<u>KAPITULLI VI</u> DOKUMENTI VETERINAR PER IMPORT DHE TRANZIT TE KAFSHEVE TE GJALLA NGA VENDET E TRETA NE SHQIPERI	FAQE	27
<u>KAPITULLI VII</u> DOKUMENTI VETERINAR PER IMPORT DHE TRANZIT TE PRODUKTEVE NGA VENDET E TRETA NE SHQIPERI	FAQE	32
<u>KAPITULLI VIII</u> KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT TE KAFSHEVE TE GJALLA	FAQE	37
1. BAZA LIGJORE	FAQE	37
1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR	FAQE	37
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	37
2. MBERRITJA	FAQE	37
3. KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT	FAQE	38
4. DESTINACIONI ESHTË IMPORTIMI	FAQE	38
5. DESTINACIONI ESHTË TRANZIT	FAQE	38
6. KAFSHET E GJALLA QE KTHEHEN MBRAPSHT NE SHQIPERI	FAQE	38
7. TRANZIT NE NJE VEND TJETER PA U SHKARKUAR	FAQE	39
8. KONTROLLI I DVIT	FAQE	39
<u>KAPITULLI IX</u> KONTROLLI I IDENTITETIT TE KAFSHEVE TE GJALLA	FAQE	40
1. BAZA LIGJORE	FAQE	40
1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR	FAQE	40
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	40
2. PROCEDURAT	FAQE	40
2.1 TE PERGJITHSHME	FAQE	40
2.2 SPECIFIKE	FAQE	41
<u>KAPITULLI X</u> KONTROLLI FIZIK I KAFSHEVE TE GJALLA	FAQE	41

1. BAZA LIGJORE	FAQE	42
1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR	FAQE	42
1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN	FAQE	42
2. ÇESHTJET MBESHTETESE	FAQE	42
3. PROÇEDURAT	FAQE	43
3.1 KAFSHET PA EKZAMINIM KLINIK	FAQE	43
3.2 KAFSHET E ÇERTIFIKUARA ME STATUSIN “TE LIRE NGA PATOGJENE SPECIFIK” TE PERCAKTUAR PER LABORATORE DHE PESHQ, KRUSTACE DHE MOLLUSQE. TRANSPORTUAR NE KONTENIERE TE MBYLLUR DUKE SHTUAR	FAQE	43
3.3 RUMINANTET DHE NJETHUNDRAKET	FAQE	44
4. KONTROLLI FIZIK	FAQE	44
4.1 EKZAMINIMI KLINIK	FAQE	44
4.2 PERSHTATJE PER TRANSPORT	FAQE	44
4.3 MARRJA E MOSTRAVE	FAQE	44
<u>KAPITULLI XI</u> DERGESAT E REFUZUARA	FAQE	45
1. RI-IMPORTIMI I DERGESAVE TE KTHYERA NGA NJE VEND I TRETE	FAQE	45
2. DERGESAT QE REFUZOHEN	FAQE	46
3. PROCEDURAT E REFUZIMIT	FAQE	47
4. PRODUKTET E RREZIKSHME PER SHENDETIN PUBLIK DHE TE KAFSHEVE	FAQE	48
5. MBETJE MBI NORMA OSE TE NDALUARA	FAQE	48
<u>KAPITULLI XII</u> TRANZITET PERMES TERRITORIT SHQIPTAR	FAQE	50
1. KUSHTET E PERGJITHSHME PER TRANZITIN E DERGESAVE/ NGARKESAVE TE DERGUARA NGA NJE VEND I TRETE TEK NJE TJETER NEPERMJET TERRITORIT SHQIPTAR	FAQE	50
2. NDERMARRJA E SHKATERRIMIT TE DERGESAVE TE REFUZUARA TE RIKTHYERA NE TERRITORIN SHQIPTAR	FAQE	50
3. PARAQITJA NE NJE PIK DHE KONTROLLET VETERINARE TE DERGESAVE TRANSITI NE TERRITORIN SHQIPTAR	FAQE	50
4. KOMUNIKIMET NEPERMJET PIK-eve.	FAQE	51
4.1 FORMULARET PER NGARKESAT E PAPANUARA NE IMPORT	FAQE	52

HYRJA

Qellimi kryesor i ketij **Manuali** eshte te ofroje nje mjet per personelin e perfshire ne kontrollin e kufirit te kafsheve te gjalla dhe produkteve me origjine shtazore ne import nga vendet e trete ne Shqiperi.

1 PERKUFIZIME

- **“P.I.K.”** domethene (nenkupton) Pike Inspektimit Kufitar;
- **“A.K.Q.”** domethene “Autoriteti Kompetent Qendror” (Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit – Drejtoria e Sherbimit Veterinar);
- **“A.K.L.”** domethene “Autoriteti Kompetent Lokal “ (Pika Kufitare e Inspektimit, Zyra veterinare e Qarkut);
- **“Sh.Z.V.”** domethene “Sherbimi Zyrtar Veterinar”
- **“V.Z.”** domethene “Veterineri Zyrtar” (Veteriner qe eshte caktuar zyrtarisht si veterineri Zyrtar nga A.K.L.)
- **“Produkt ne tranzit/kafshe te gjalla ne tranzit”** nenkupton nje produkt ose kafshe e gjalle nga nje Vend i Trete i cili fillimisht ka hyre permes doganes ne territorin e Shqiperise ne Piken e Inspektimit Kufitar, i caktuar tranzit per nje vend tjetër te trete edhe nese jane ose jo shkarkuar ne piken e pare te inspektimit kufitar.
- **“DVIT”** domethene “Dokumenti Veterinar per Import dhe Tranzit”. Dokumentat leshohen per produkte ose kafshet e gjalla. Eshte nje dokument i leshuar nga SHZV qe verteton rezultatet e kontrolleve.
- **“Ngarkese”** nenkupton sasine e produktit te te njejtij tip qe mbulohen nga e njejta certifikate veterinare ose dokument veterinar, ose dokumenta te tjera te parashikuara nga legjislacioni veterinar, te transportura nga te njejta mjete transporti dhe qe vijne nga i njejti vend i trete ose nga nje nje pjese e nje vendi te trete.
- **“Deklarata e Kapitenit”**: dokumenti original per shkarkimin e pare te produkteve te peshkimit nga nje Vend i Trete.
- **“Sistemi Elektronik”**: Sistemi kompjuterik i cili perdoret per kontrollin kufitar.
- **“Importuesi”**: Person fizik me vendbanim zyrtar ne Shqiperi ose agjenti i tij.
- **“Kontrolli i Dokumentacionit”**: "kontrolli i certifikatave vetrinare ose dokumentave shoqerues te produktit ose kafsheve te gjalla ose nje grupi te tyre”.
- **“Kontrolli i indentitetit te produkteve me origjine shtazore”** kontrolli vetem me ane te inspektimit visual, per sigurimin e perputhshmerise se certifikata(at) veterinare ose dokumet(at) vetrinare te parashikuara nga legjislacioni veterinar me vete produktin”.

- **“Kontrolli i identitetit të kafsheve të gjalla”** nënkupton verifikimin vetëm nga inspektimi vizual për përputhshmeri midis dokumentave ose certifikatave dhe pranise së kafsheve dhe përputhje të shenjave që duhet të paraqesin këto kafshe.
- **“Kontrolli fizik i produkteve me origjinë shtazore”:** "Kontroll i vetë produkteve, mundësisht duke përfshirë marrjen e mostrave dhe analizimin laboratorik".
- **“Kontrolli fizik i kafsheve të gjalla”:** “Kontrolli i vetë kafsheve të gjalla, mundësisht duke përfshirë marrjen e mostrave dhe kontrollin laboratorik dhe kur është e përshtatshme kontrollet shtesë të bërë gjatë karantines”.

KAPITULLI I

KONTROLLET VETERINARE AKTUALE (PRODUKTE SHTAZORE DHE KAFSHE TE GJALLA)

1. LEGJISLACIONI

1.1 LEGJISLACIONI AKTUAL KOMBETAR

Ligji Parlamentar nr. 9308 i dates 04/11/04 mbi sherbimin dhe inspektoriatin veterinar - organizimi, funksionimi dhe financimi i sherbimit veterinar dhe inspektoriatit, autoriteti dhe detyrat e administrates veterinare.

1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN

- Direktiva e Keshillit 91/496/ KE – Organizimi i kontrolleve veterinare per kafshet e gjalla te importuara nga Vendet e Treta;
- Vendimi i Komisionit 94/360/KE – Frekuenca e reduktuar, kategorite, regjistrimi i kontrolleve;
- Vendimi i Komisionit 97/794/KE – Kontrollet veterinare mbi kafshet e gjalla te ardhura nga Vendet e Treta;
- Direktiva e Keshillit 97/78/KE – Parimet e Kontrolleve Veterinare ne Vendet e Treta;
- Vendimi i Komisionit 97/152/KE – Regjistrimi i dergesave te kthyera;
- Vendimi i Komisionit 97/394/KE – Baza e te dhenave per dergesat e deklaruar;
- Vendimi i Komisionit 2000/208/KE – Rregullat e detajuara te tranzitit nga nejtend i 3te tek nje vend tjetertend i trette;
- Vendimi i Komisionit 2001/812/KE – Kerkesat per aprovimin e PIK-ve.
- Vendimi i Komisionit 2001/881/KE – Lista e Pika te Inspektimit Kufitar (e ndryshuar);
- Direktiva e Keshillit 2002/99/KE - prodhimi, perpunimit, shperndarja dhe futja e produkteve me origjine shtazore per konsumim human;
- Vendimi i Komisionit 2003/279/KE – Certifikata e kontrolleve veterinare te produkteve nga Vendet e Treta;
- Vendimi i Komisionit 2007/275/KE – Lista e produkteve per tu kontrolluar;

- **Direktiva e Keshillit 2004/68/KE** – Importimi dhe tranziti i kafsheve te gjalla njethundrake te caktuara;
- **Rregullorja e Parlamentit Europian (KE) 136/2004** – Procedurat e PIK-ut, Dokumentin e Perbashket Hyres Veterinar (CVED), bari i thate dhe kashte;
- **Vendimi i Komisionit 282/2004/KE** – Certifikata veterinare e kontrolleve te kafsheve nga Vendete Treta;
- **Rregullorja e Parlamentit Europian (KE) 852/2004** – Higjena ushqimore;
- **Rregullorja e Parlamentit Europian (KE) 853/2004** – Rregulla specike mbi higjenen e produkteve ushqimore;
- **Rregullorja e Parlamentit Europian (KE) 854/2004** - Rregullat specifike per organizimin e kontrolleve zyrtare mbi produktet me origjine shtazore te destinuar per konsum njerezor;
- **Rregullorja e Parlamentit Europian (KE) 882/2004** – Ligji i ushqimit dhe ushqimit per blegtori, rregullat e shendetit te kafsheve dhe mireqenies se kafsheve;
- **Rregullorja e Parlamentit Europian (KE) 1774/2002** - rregullat e shendetit ne lidhje me nenproduktet e kafsheve qe nuk jane te destinuar per konsum njerezor .

2. PROCEDURAT PER KONTROLLET VETERINARE

2.1 KONTROLLET E DUHURA

Nje sistem efektiv i kontrollit kufiritar kerkon qe te gjitha dergesat e produkteve shtazore/kafshe te gjalla nga Vendet e Treta te importuar ne Shqiperi duhet te kene bere kontrollin e dokumentacionit te identitetit dhe fizik nen pergjegjesine e V.Z. perpara se te lirohet per qarkullim te lire. Kontrollat duhet te kryhen perpara se te jepet deklarata doganore. Importuesi duhet te paguaje kostot e kontrolleve.

Ne rastet e nevojshme mund te hartohen marreveshje te barazvlefshme me partneret tregtare te medhenj. Keto marreveshje mund te percaktojne zvogelimin e frekuences se kontrolleve fizike mbi produktet shtazore/kafsheve te gjalla nga ato vende.

2.2 PRODUKTET PER TU KONTROLLUAR

Cdo ngarkese e produkteve me origjine shtazore/kafshe te gjalla duhet ti nenshtrohet kontrollit veterinar kur importi ne Shqiperi vjen nga nje vend i Trete. Sipas ketij parimi, nje liste reference e produkteve qe kerkojne kontrolle veterinare eshte parashikuar ne Vendimin e Komisionit 2007/275/KE. Pervec ketyre duhet te kontrollohen produktet si bari i thate, kashte, dhe produktet bimore te destinuar per ushqim kafshesh.

2.3 NJOFTIMI I MBERRITJES DHE PREZANTIMI I KERKESAVE

1. Personi pergjegjes per ngarkesen duhet te siguroje qe te gjitha produktet me origjine shtazore jane paraqitur ne nje PIK te miratuar per kete produkt. Personi pergjegjes per ngarkesen duhet te njoftoje paraprakisht SHZV ne PIK per mberritjen e ngarkeses.
2. Importuesi eshte pergjegjes per njoftimit e PIK-ut dhe per plotesimin e Pjeses 1 te DVIT
3. Njoftimet duhet te behen perpara mberritjes per dergesat qe vijne me rruge tokesore, hekurrudhe/rruge, ose nga ajri dhe nje dite pune perpara per te gjitha ngarkesat e tjera.
4. Dergesat duhet te paraqiten tek PIK-u "pa vonese" pas/qe nga mberritja ne Shqiperi.
5. Dergesat duhet te jene paraprakisht te njoftuara duke paraqitur pjesen 1 te DVIT tek PIK-u.
6. Punonjesit e PIK-ut mund te inspektojne vizualisht dergesat ne fjale dhe manifestin e ngarkeses ose mjetet e tjera elektronike, duke siguruar me shkrim qe eshte rene dakort nga VZ qe te dhenat kryesore ne lidhje me dergesen perfshihen ne pjese 1 te DVIT.
7. Nese sistemi kompjuterik perdoret per njoftim, duhet qe ai ne menyre aktive te sinjalizojte beje me shenje dergesat ne menyre qe te beje vigjilent VZ.

3. DOKUMENTACIONI I P.I.K.-ut.

3.1 DOKUMENTAT QE DUHET TE MBAHEN

Veterineri zyrtar pergjegjes per kontrollin ne PIK duhet te kete ne dispozicionin e tij ne cdo kohe te pakten informacionin e meposhtem dhe dokumentacionin ne zyren kryesore te caktuar:

- (i) Nje liste te perdituesuar te vendeve te treat ose pjeseve te vendeve te treat te autorizuar per te derguar produktet ne Shqiperi, ose ne rastet kur eshte e aplikueshme ne disa vende fqinje;
- (ii) kopje te ndryshme te legjislacioneve te permendura me lart ose, kur eshte e zbatueshme te legjislacionit te vendeve fqinje duke specifikuar nje model shendetesor ose publik/certifikate shendetesore e kafsheve ose ndonje dokument tjetër i cili mund te shoqeroje produktet nga vendet e treta te derguara ne Shqiperi ose ne Vendet fqinje;
- (iii) Nje liste te perdituesuar te stabilimenteve ne vendet e treat te autorizuar per te derguar produkte ne Shqiperi;
- (iv) Kopje te ndonje mase sigurie qe ndalojne ose kufizojne importet e produkteve ose kafsheve te gjalla ne Shqiperi;
- (v) Nje liste kombetare e perdituesuar e PIK-eve te KE dhe vendeve fqinje duke dhene te gjitha detajet e nevojshme e ketyre pikave kufitare;
- (vi) Nje liste aktuale e zonave te lira kombetare, magazinave te lira dhe magazinave doganore;

- (vii) Nje liste e perditesuar e stabilimenteve te aprovuara per pranimin e produkteve qe duhet te paraqiten nen nje regjim te vecante;
- (viii) Legjislacioni kombetar i perditesuar per produktet, kafshet e gjalla dhe procedurat e mbuluara nga kontrollet veterinare.

3.2 PERGJEGJESITE E SHVZ TE PIK-UT

- A.** Te siguroje qe produktet me origjine shtazore dhe kafsheve te gjalla qe jane paraqitur ne PIK jane kontrolluar;
- B.** Te siguroje qe pajisjet e nevojshme dhe objektet e kerkuara nga legjislacioni perkates jane ne dispozicion te PIK-ut per te mundesuar kryerjen ne menyre efektive te kontrolleve veterinare;
- C.** Te siguroje qe jane marre mostrat e mjaftueshme e te pershtatshme dhe jane derguar per analizim laboratorik sipas planit kombetar te monitorimit (kur eshte e pershtatshme);
- D.** Te jete prezent te PIK kur kontrollet veterinare jane ne zhvillim (perfshire ketu edhe kontrollin e dokumentacionit);
- E.** Te leshoje DVIT-at per te gjitha ngarkesat dhe te lajmeroje refuzimet ne rastet kur dergesat nuk e kalojne kontrollin veterinar;
- F.** Te siguroje qe dergesat e refuzuara jane trajtuar dhe asgjesuar ne perputhje me legjislacionin perkates;
- G.** Te siguroje qe personeli i PIK-ut jane manaxhuar dhe trajnuar sic duhet;
- H.** Te siguroje qe te gjitha dokumentet e kerkuara/rregjistruara mbahen ne PIK dhe refuzimet mujore dergohen ne AKQ;
- I.** Te siguroje qe sistemi informativ, kur eshte i aplikueshem, eshte monitoruar per mesazhet e ardhura dhe kur eshte e nevojshme te siguroje qe mesazhet dalese jane derguar dhe hyrjen e te dhenave te tjera kur eshte e nevojshme;
- J.** Te drejtoje dhe te jete prezent ne auditime te jashtme (p.sh. AKQ., Organizatata nderkombetare, etj.);
- K.** Te siguroje qe PIK-u eshte manaxhur ne menyre higjienike duke respektuar rregullat higjienik te parashikuara per produktet e marra ne konsiderate duke mos paraqitur rrezik per produktet/kafshet e gjalla qe mbahen.
- L.** Te mbaje lidhje me zyrtaret e doganave per sigurimin e masat te pershtatshme per identifikimin e produktet me origjine shtazore/kafsheve te gjalla kontrabande dhe parandalimin e mallrave te pa kontrolluar qe te lene portin/aeroportin.
- M.** Te ndjeke mallrat e derguara nen nje regjim te caktuar nese nuk eshte marre komnfirmimi qe ngarkesa ka mberritur ne destinacionin e tij.

4. KONTROLLET POLICI-NGARKESE (E LISTES SE PRODUKTEVE/ MALLRAVE)

SHZV ne PIK duhet te kete te drejte ne kontrollin e manifestit te anijeve dhe avioneve per te kontrolluar ne menyren e duhur produktet me origjine shtazore/kafshet e gjalla.

- A) Autoriteti i PIK-ut duhet te kete te drejte ne kontrollin e manifestit ose te informacioneve te ngjashme te cilat mbahen nga operatoret ose perdoruesit e porteve. Kontrolli i manifestit duhet te vihet ne dispozicion te Sh.Z.V. kur kerkohet. Sh.Z.V. duhet te informoje per kontrollet e realizuara nga Autoritetet Doganore ne zbulimin e produkteve te pa deklaruar.
- B) A.K.Q. do te kontrolloje teresisht per te siguruar qe PIK-u zbaton procedurat e kontrollit dhe burimet e informacionit dhe te sigurojne qe jane ne dijeni per te gjitha dergesat qe mund te permbajne produkte me origjine shtazore/kafshe te gjalla te cilat kalojne permes portit/aeroportit dhe nese jane deklaruar sic duhet ose jo.
- C) Procedurat per zbulimin dhe ndalimin e ngarkesave te dyshimta duhet te percaktohen.
- D) SH.Z.V duhet te kete te drejte te pa kufizuar informimin per te gjitha dergesat e transportuara me mjetet e transportit perkates. Keto procedura duhet te mbulojne dergesat qe jane per import dhe ato per transit.

5. KONTROLL I LISTES

Per lehtesimin e kryerjes se kontrolleve mund te jete e nevojshme lista e kontrollit paraqitur ne aneks.

ANEKS

Nr. i DVIT _____

KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT

Komentet

Lloji i Kontrollit	PO	JO	FIRMA
Pagesat e taksave			
Pjesa I e DVIT e plotesuar sakte dhe e firmosur			
Para njoftimi i PIK-ut para mberritjes se mallrave			
Vend i Trete i autorizuar dhe produkti i autorizuar			
Bime te autorizuar			
Certifikata sanitare ne perputhje me legjislacionin komunitar			
Certifikata sanitare ne perputhje me legjislacionin kombetar			

Certifikata sanitare ne perputhje me principet e pergjithshme te certifikimit			
Vula dhe firma origjinale e Autoritetit Kompetent			
Dokumente te tjera kur nuk kerkohen certifikata saitare (fatura e ngarkeses, CMR, te tjera)			
VENDIMI PER KONTROLLET			
Kontrolli i plote i identitetit			
Kontrolli i vules/plumbosjes			
Kontrolli fizik			
Kontrollet e reduktuara			
Analizimi Laboratorik dhe Pershkrimi			
I detyrueshem			
I rastit			

KONTROLLI I IDENTITETIT

Lloji i Kontrollit	I kenaqshem	Jo i kenaqshem	Firma
Kontrolli i Plote			
Kontrolli i vulosjes/plumbosjes			

KONTROLLI FIZIK

Lloji i Kontrollit	I kenaqshem	Jo i kenaqshem	Firma
Zinxhiri i ftohjes korrekt			
Kontrolli i transportit			
Paketimi			
Etiketimi			
Kontrolli Organoleptik			
Kontrolle te thjeshta fizike kimike: shperberja, prerja			

KONTROLLI LABORATORIK

Lloji i Kontrollit	I kenaqshem	Jo i kenaqshem	Firma

Komente:

KAPITULLI II

KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE

Objekivi : Te kryej kontrollin e dokumentacionit (D-kontroll) mbi dokumentat qe shoqerojne produktet dhe mbi DVIT (Dokument veterinar per import dhe tranzit) per produktet me origjine shtazore nga Vendet e Treta te cilat jane paraqitur ne Pikat e Inspektimit Kufitar Shqiptar per import, ruajtje ose tranzit.

Kontrolli i dokumentacionit konfirmon qe dokumentat, (pergjithesisht certifikatat) te cilat kerkohen nga legjislacioni perkates, jane leshuar dhe jane ne perputhje me detajet e kushteve per importimin nga Vendet e Treta.

1. HAPESIRA LIGJORE

1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR:

- ***Ligji Parlamentar nr. 9308 dt. 04/11/04*** “Mbi sherbimin dhe inspektoriatin veterinar”-organizimi, funksionimi dhe financimi i sherbimit veterinar dhe inspektoriatit, autoriteti dhe detyrat e administrates veterinare.

1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN

- ***Direktiva e Keshillit 97/78/EC***
- ***Rregullorja e Parlamentit European (KE) 136/2004***

2. MBERRITJA

2.1 PARAQITJA E INFORMACIONIT PERKATES NE PIK (PIKA INSPEKTIMIT KUFITAR)

- A) Importuesi (ose agjenti i tij) dorezon certifikaten origjinale veterinare dhe pjesen e pare te DVIT e firmosur nga veterineri pergjegjes ne piken kufitare. Personeli i pikes se inspektimit kufitar kontrollon DVIT dhe dokumentat veterinare shoqerues dhe dokumenta te tjera te disponushem (fature ngarkese, faturat etj) .
- B) Personeli i PIK–ut mund te plotesoje per importuesin ne menyre te vecante pjesen e pare te DVIT.

- C) Çertifikata origjinale kontrollohet për saktësinë e tij (origjinalitetit). Origjinalet do t'i kalohen perseri importuesit në rastet e tranzitit apo transferimit (shiko seksionin – TRANZIT).
- D) Me aprovimin e importuesit, personeli i PIK-ut mund të korigjojë datën e munguar ose gabuar.
- E) Pas kontrollit të dokumentacionit DVIT, shënohet numri i DVIT dhe zbatimi i regjimit të kontrollit të reduktuar.
- F) DVIT do të mbahen në PIK deri në përfundimin e procedurave të kontrollit.

2.2 KONTROLLI I DVIT

Nese :

- DVIT është i plotësuar teresisht.
- Data në certifikatën origjinale është e njëjtte me atë të plotësuar në DVIT, por fusha 9 e DVIT mund të plotësohet me një adresë tjetër shpërndarjeje nga ajo e shënuar në certifikatë në fushën 3 të DVIT. Ky përjashtim nuk është i mundur për produkte të kanalizuar. Fusha 9 është adresa në lidhje për të gjitha kontrollet dhe vendimet mbi këto ngarkesë.
- PIK-u është aprovuar për këto kategori produktesh (HC/N-HC, T/N-T).
- Në rastet e kthimit të ngarkesës, destinacioni duhet të jetë vendi nga ku është dërguar certifikata në Shqipëri.
- Në rastet e magazinimit, në magazine ose tek furnizuesi, adresa e destinacionit duhet të verifikohet në listën zyrtare të këtyre stabilimenteve në Shqipëri.

2.3 PROCEDURAT E ZAKONSHME PËR KONTROLLET E DOKUMENTACIONIT TË PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE NGA VENDET E TRETA.

Rregullat e mëposhtme procedurale do të aplikohen për kontrollin e dokumentacionit të produkteve me origjinë shtazore nga Vendet e Treta:

- A. Çdo ngarkesë duhet të ketë një kontroll dokumentacioni që të sigurojë që njoftimi dhe dokumentat shëndetësore veterinarë përputhen, dhe që dokumentat përmbushin kërkesat e legjislativës për produktin në fjalë (të marrë në konsideratë).
- B. Për çdo ngarkesë, V.Z. duhet të përcaktojë trajtimin e menduar doganor të miratuar ose përdorimi i mirë të cilit të jetë përfitues.
- C. Çdo certifikatë ose dokument për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik i cili shoqëron ngarkesën e produkteve me origjinë nga një vend i tretë dhe paraqitet në PIK duhet të inspektohet në mënyrë që të konfirmohet si e përshtatshme:
 - Që është certifikata ose dokumenti origjinal;
 - Që i referohet një vendi të tretë ose një pjesë të një vendi të Tretë të autorizuar për të eksportuar në Shqipëri, ose në qoftë se ngarkesa është në tranzit për tek një vend i tretë në fjalë;

- Dergesa është e shoqëruar nga një model i saktë i dokumentit për /vendin / destinacionin e kombinuar, plotësisht i plotësuar dhe origjinal (leje importi ose manualin e importit);
- certifikata origjinale është në një faqe ose dy faqe por të lidhur qartësisht me njëri tjetrin.
- Ajo duhet të jetë në gjuhën shqipe ose mundësisht e kombinuar me gjuhë të tjera.
- Certifikata origjinale është e pranueshme kur shqërohet nga një përkatës zyrtar në gjuhën shqipe;
- Data e kufijve të certifikates (veterinare) ose dokumentit duhet të jetë në lidhje të arsyeshme me datën apo kohën e udhëtimit me anë të mjeteve specifike të transportit tek mbërritja në PIK;
- Që është plotësisht e plotësuar;
- Që i referohet një stabilimenti ose mjeti të autorizuar ose regjistruar të eksportit në Shqipëri ose në një vend tjetër të tretë nëse ngarkesa është në tranzit;
- Certifikata është leshuar përpara se ngarkesa të ketë lënë kontrollin e autoriteteve kompetente të origjinës;
- Në qoftë se certifikata tregon se si të plotësohet atëherë këto rekomandime duhet të respektohen. Në qoftë se modeli i certifikates përcakton fshirjen e disa pjesëve atëherë kërkesat përmbushen vetëm në qoftë se teksti përkatës është printuar dhe kur pjesët e destinuara për fshirje janë lënë jashtë (janë fshirë);
- Që është e firmosur nga veterineri zyrtar ose, ku është e pershtatshme, nga përfaqësuesi i autoritetit zyrtar, dhe tregon në mënyrë të kuptueshme dhe me shkronja kapitale emrin dhe pozicionin e tij/saj, dhe gjithashtu që vula zyrtare shendetësore e vendit të tretë dhe firma zyrtare janë në ngjyrë të ndryshme nga ajo e printimit të certifikates, ose për certifikatat elektronike firma dhe vula janë të bera nga një sistem sigurie;
- Emri, firma origjinale dhe vula zyrtare janë në një ngjyrë tjetër nga pjesa tjetër e dokumentit. Përdorimi i vules së thatë (p.sh. certifikata USDA) është i pranueshëm.

2.4 PERJASHTIME DHE SHMANGIE

- A. Perjashtimet mund të jepen vetëm nga strukturat drejtuese. Këto perjashtime mund të shpërndahen PIK-eve në formë të shkruar ose të vendosen në lejen e importit.
- B. Në rastet e shmangieve, zyrtari i PIK-ut ndërmerr hapat e nevojshëm për korrigjimin nga importuesi dhe autoriteti leshues. Ngarkesa mund të perjashtohet nga regjimi i kontrollit të reduktuar.
- C. Cdo ndryshim në certificate duhet të shqyrtohet ngushtësisht në mënyrë që të zbulohet ndonjë mundësi mashtrimi.
- D. Letra e përdorur duhet të jetë e tejdukshme.
- E. Cdo ndryshim në certificate duhet të jetë i aprovuar (jo e detyrueshme) dhe të jetë i vulosur dhe firmosur nga i njëjti person që ka firmosur certifikatën.

- F.** Ndryshimet e shenuara qe ne fillim mund te pranohen me shume vemendje nga Sh.V.Z.
- G.** Versionet e faksuara ose te fotokopjuara nuk mund te konsiderohen si documentet origjinale, pasi nuk eshte e mundur te dallohen ndryshimet e bera duke perdorur leter transparente ose ndonje ndryshim tjeter mashtrues.
- H.** Ne qofte se dergesa eshte e paraqitur me nje certifikate te fotokopjuar ose faksuar duhet ti behet e qarte importuesit ose agjentit te tij qe dergesa nuk do te pranohet deri sa te prodhohet certifikata origjinale.
- I.** I vetmi perjashtim eshte per mallrat tranzit ose tranzit nga deti per nje vend tjeter ku nje kopje autentike (p.sh. kopja qe ka firmen origjinale te Sh.V.Z. ne vendin eksportues) mund te pranohet per kontrollin e dokumentacionin.

KAPITULLI III

KONTROLLI I IDENTITETIT TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE

OBJEKTIVI : Te kryhet kontrolli i identitetit (Kontrolli ID) per produktet me origjine shtazore nga vendet e treta te cilat paraqiten ne pikat e inspektimit Shqiptar per import, magazinim ose tranzit.

1. HAPESIRAT LIGJORE

1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR:

Ligji Parlamentar nr. 9308 dt 04/11/04 “Mbi sherbimin dhe inspektoriatin veterinar” organizimi, funksionimi dhe financimi i sherbimit veterinar dhe inspektoriati, autoriteti dhe detyrat e administrates veterinare.

1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN

- *Direktiva e Keshillit 97/78/EC*
- *Rregullorja e Parlamentit European (EC) 136/2004*

2. PROÇEDURAT

2.1 PROCEDURA E KONTROLLIT TE IDENTITETIT

Kontrolli i Identitetit duhet te realizohet ne menyre qe te siguroje si me poshte:

- Qe te dhenat qe shfaqen ne dokumentin shoqerues korrespondojne me karakteristikat e dergeses.
- Ne rastet e konteniereve te mbyllur (ku numri i vulosjes eshte i shenuar ne certifikaten veterinare ose ne dokument) duhet te kontrollohet paprekshmeria dhe munri i vulosjes.
- Kontrolli i identitetit duhet te realizohet ne 1% te njesise te paketuara me minimum 2 njesi dhe maksimum 10 njesi. Ky 1% eshte marre si nje perfaqesim nga e gjitha ngarkesa.
- Ne rastet e marrjes se mostrave nga personeli ndihmes, Sh.V.Z i PIK-ut eshte prezent dhe cakton mostrat.
- Nese paketat hapen ato duhet te mbyllen me etiketen e inspektimit te PIK-ut.
- Ne rastin e produkteve te pa-paketuara kontrolli i identitetit duhet te behet permes llojit te produktit (nese eshte e mundur/aplikueshme) dhe mjetit te transportit (numri i regjistrimit, emri) qe korrespondon ne certificate.

- Ne rastin e perjashtimeve, kontrolli i identitetit do te zgjerohet te pakten edhe me numrin e mostrave ne tabelen 1 te aneksit 1. Ne rastin e kontejnereve ne det vendndodhjen e mostrave te zgjeruar do te zbatohet ne perputhje me aneksin 2.
- Sh.V.Z. e PIK-ut do te realizoje kontrole fizike edhe ne qofte se fillimisht nuk kerkohet.
- Vulosja pas kontrollit eshte pershkruar ne kontrollin fizik te produkteve.

2.2 RASTET SPECIFIKE

A) Destinacioni eshte Importimi

- Personeli i PIK-ut verifikon qe te dhenat ne dokumentin original korrespondojne me mjetet e transportit, natyren e produkteve dhe me traguesit e pakove.
- Duhet te kontrollohet prezenca/prania e vules zyrtare ose shenjave per identifikim ne lidhje me vendin e origjines dhe stabilimenteve te aprovuara (nese eshte e aplikuar).
- Duhet te verifikohen udhezimet Shqiptare ne rastet e kerkesave specifike per etiketim.
- Ne qofte se ngarkesa eshte perzgjedhur per nje Kontroll te Reduktuar, kontrolli i identiteit mund te behet vetem nepermjet numrit te vulosjes dhe numrit te kontenierit, vetem nje kontroll Identiteti: kontroll i numrit te vules dhe i kontenierit jane pjese e detyrueshme e certificates veterinare.

B) Destinacioni eshte tranzit direkt pa magazinim te ndermjetem

Ne rastin e konteniereve te mbyllur Kontrolli i identitetit mund te kryhet behet vetem nepermjet kontrollit te vules dhe numrit te kontenierit nen kushtet e meposhtme:

- Destinacioni i ngarkeses/dergeses eshte Vendi i Trete me transport permes territorit Shqiptar ose nje vendi te huaj nga nje anije tranziti.
- Numri i kontenierit dhe numri i vulosjes jane nje pjese e detyrueshme e certificates apo dokumentit origjinal veterinar.
- Kontrolli i dokumentacionit ishte konform.

C) Destinacioni i dergeses eshte nje magazine e lire ne Shqiperi.

Ne kontrollin e identitetit duhet te vertetohen qe te dhenat ne certifikaten apo dokumentin shoqerues veterinar te korrespondojne me karakteristikat e dergeses. Minimalisht vendi i origjines dhe natura e produktit duhet te tregohen ne dergese.

Ne rastet kur ne certifikaten apo dokumentin veterinar dhe mbi pakot permenden numrat e stabilimenteve, grup numrash, numri i certifikates, ato duhet te jene te perputhshme. Por keto te dhena nuk jane te detyrueshme per dergesat tranzit.

Aneks 1

Tabela 1: Menyra e shperndarjes se marrjes se mostrave ne rastin e perjashtimeve.

Numrat e mostrave per njesi pakete < 1 kg peshe neto	
Njesi Pakete	Numer mostrash
< 4800	13
4801 - 24000	21
24001 - 48000	29
48001 - 84000	48
84001 - 144000	84
144001 - 240000	126
≥ 240001	200

Numrat e mostrave per njesi pakete ≥ 1 kg. dhe < 4,5 kg peshe neto	
Peshe Neto	Numer mostrash
< 2400	13
2401 - 15000	21
15001 - 24000	29
24001 - 42000	48
42001 - 72000	84
72001 - 120000	126
≥ 120001	200

Numrat e mostrave per njesi pakete ≥ 4,5 kg peshe neto	
Peshe Neto	Numer mostrash
< 600	13
601 - 2000	21
2001 - 7200	29
7201 - 15000	48
15001 - 24000	84
24001 - 42000	126
≥ 42001	200

Aneks 2

Tregues per vendin e marrjes se mostrave ne konteniere ne det.

Duke e pare nga prapa ne kontenierin e hapur vendet do te jene sipas skemes me poshte:

LM = Lart Majtas
 LD = Lart Djathtas
 AML = Ana Majtas Lart
 ADL = Ana Djathtas Lart
 AMP = Ana Majtas Poshte
 ADP = Ana Djathtas Poshte
 PM = Poshte Majtas
 PD = Poshte Djathtas
 ML = Mes-Lart
 MP = Mes-Poshte

	LM	LD	
AML			ADL
		ML	
		MP	
AMP			ADP
	PM		PD

KAPITULLI IV

KONTROLLI FIZIK I PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE

OBJEKTIVI

- I. Te kryhet kontrolli fizik per produktet me origjine shtazore qe vijne nga jashte te cilat paraqiten ne Pikat e Inspektimit Kufitar ne Shqiperi. Kontrolli fizik ka si objektiv te verifikojte nese produktet perputhen me perdorimin e percaktuar ne certifikaten veterinare shoqeruese ose dokument e DVIT duke qene se ato jane ne perputhje me kushtet e percaktuar ne legjislacionin Shqiptar.
- II. Kontrollet e pakove te hapura duhet te behet vetem ne dhomat e inspektimit te PIK-ut.

1. HAPESIRA LIGJORE

1.1 LEGJISLACIONI KOMBETAR:

- Ligji Parlamentar nr. 9308 dt. 04/11/04 “Mbi sherbimin dhe inspektoriatin veterinar” - organizimi, funksionimi dhe financimi i sherbimeve veterinare dhe inspektoriatin, autoriteti dhe detyrat e administrates veterinare.

1.2 LEGJISLACIONI BASHKIMIT EUROPIAN

- Direktiva e Keshillit 97/78/KE
- Rregullorja e Parlamentit European (KE) 136/2004
- Vendimi i Komisionit 94/360/KE (Kontrollet e reduktuara)

2. CESHTJET MBESHTESE

- Etiketat e inspektimit dhe nese eshte e aplikuar vulat;
- Udhezimet e brendshme;
- Mjetet per hapjen e dergeses dhe marrjen e mostrave (thikat, sharra, turiele etj.);
- Termometer (dixhital ose jo);
- Pajisje e shperberjes;
- Materialet e paketimit dhe vulosjes per te transportuar ne laborator mostrat perfshire ketu edhe kontenjeret ftohes te transportit;
- Frigorifer dhe ngrires per ruajtjen e mostrave;
- Rregjistrimi i mostrave te marra per ekzaminimin laboratorik dhe rezultatet e tyre (shiko aneksin TEST LAB);

3. PROCEDURAT

3.1 SISTEMI I KONTROLLEVE TE REDUKTUARA: PERCAKTIMI PER KONTROLLET FIZIKE.

- Ekziston nje grup produktesh te cilat mund te perzgjidhen per regjimet e kontrollit te reduktuar (shiko aneks Dhjetor 94/360). Sistemi i kontrolleve te reduktuara na jep mundesi te reduktojme numrin e kontrolleve fizike per nje grup produktesh/vend origjine i kombinuar ku risku eshte konsideruar te jete me i ulet se mesatarja.
- Kushti i pare eshte ekzistenca e listes se Vendeve te Treta, lista e autorizuar e stabilimenteve dhe modeli i certifikates. Kushti i dyte eshte kontrolli i dokumentacionit dhe identitetit pa perjashtime. Grupi i produkteve dhe frekuenca e kontrolleve fizike eshte paraqitur ne shtojcen e ketij udhezimi. Personeli i PIK-ut duhet t'i referohet rregjistrave per frekuencen e kontrolleve fizike te kryer dhe te percaktoje ne baze te ketyre te dhenave kontrollin tjeter fizik per nje produkt, i cili duhet te behet ne menyre qe te jete afer me perqindjet e percaktuara ne aneks. Zgjedhja duhet te jete e paparashikuar por njekoheesisht jo diskriminuese per importuesit.
- Produktet/vendet qe nuk permenden ne akneks duhet te kontrollohen fizikisht 100 % .
- Dergesat ku jane gjetur perjashtime ne kontrollin e dokumentacioni / ose te identitetit duhet gjithmone te kontrollohen fizikisht. Ne rastet e dyshimta duhet te behen gjithmone kontrollet fizike, (nuhatja, statusi higjienik i mjeteve te transportit, demtimet, histori e paqarte temperature, etj.).
- Dergesat per tranzit ose per magazinat e zonave te lira, zakonisht nuk i nenshtrohen kontrollet fizike, vetem ne rastet e dyshimta te mashtrimit ose kur perben rrezik per publikun dhe/ose shendetin e kafsheve.
- Dergesat e rikthyera i nenshtrohen kontrollit fizik ne vend te certifikates se eksportit per te verifikuar statusin e dergeses dhe perdorimin e metejshem te tij.
- Nje regjister alarmesh / masa mbrojtese ose kontrolli te perforcuar mund te krijohet duke ndjekur shembullin e raportuar ne aneksin TABELA ALERT.

3.2 PERCAKTIMI I MOSTRAVE

- Kontrolli fizik mbi produktet e paketuara duhet te behet ne te njejtat mostra te perzgjedhura per kontrollin e identitetit. Pas kontrollit fizik personeli i PIK-ut mbyll pakot me etiketen e inspektimit.
- Kontrollet fizike per produktet rifuxho duhet te behet ne te pakten 5 mostra te ndryshme. Numri i mostrave mund te zgjerohet ne perputhje me udhezimet e brendshme.

3.3 MARRJA E MOSTRAVE PER KONTROLLET FIZIKE

- Per te ekzekutuar kontrollin fizik personeli i PIK-ut merr ne mbikqyrjen e tij mostrat nga njesite e zgjedhura.
- Ekzaminimi eshte i percaktuar nga lloji i kerkimit dhe nga lloji i produktit. Shiko tabelen poshte kesaj Faqe.
- Ne qofte se mostrat jane per ekzaminim laboratorik atehere pika 4.6 eshte i pershtatshem.

Tipi i produktit	
Firm personeli	Pjese te prera ose te sharruara me mjete te pastra dhe te dezinfektuara.
Pluhura	Marrja e mostrave me luge ose me turiele.
Lengjet	Luge marrese perkatese, mjalti me luge te vecante.
Te gjitha produktet	Ne varesi te ekzaminimit, mostrat duhet te merren ne menyre sterile. Mostrat duhet te ftohen nese nuk cilesohet ndryshe.

Steriliteti i nevojshem ose jo	
N.q.s. steriliteti eshte i nevojshem	Te gjitha mjetet dhe materialet jane sterile. Duhet qe personi qe merr mostren te kete nje vemendje te vecante ne menyre qe mostra te qendroje e painfektuar /ndotur gjate gjithe procesit.
Jo steriliteti i nevojshem	Te gjitha mjetet dhe materialet duhet te pastrohen.

Temperatura e mishit te kuq	
I ftohte	Maksimum. + 7°C per karkasat ose pjeset e tyre Maksimum + 3°C per te brendshmet
I ngrire	Maksimum – 12°C (Muaj dhe viti i ngrirjes duhet te jete e permendur mbi pako)

Temperatura e mishit te Shpendve	
I ftohte	Maksimum + 4°C
I ngrire	Maksimum – 12°C (Muaj dhe viti i ngrirjes duhet te jete i permendur mbi pako)

Temperatura e produkteve te peshkimit	
I ftohte	Produkte peshku te fresketa ose shkrira, butake dhe molusqe te ngrohura: temperatura e shkrirjes se akullit.
I ngrire	Produkte peshku te ngrira: Maksimum – 18°C Toleranca me +/- 3°C per periudha te shkurtra gjate transportit e pranueshme
	Produktet e perpunuara: si eshte saktësuar ne certifikaten shendetesore.

3.4 KRYERJA E KONTROLLIT FIZIK

Kontrollet fizike ne vijim kryhen nga personeli i PIK-ut.

- Ekzaminimi organoleptil perfshin p.sh.: eren, ngjyren, perberjen dhe shijen. Produktet e ngrira duhet me pare te shkrihen gradualisht ose ne mikrovale.
- Testet te thjeshta fizike te detyrueshme:
 - Prerja nese eshte e nevojshme
 - Matja e temperatures bazuar kushteve te percaktuara ne certifikate.
- Teste te thjeshta fizike fakultative (jo-sistematike):
 - Gatim - Pjekje – Degustim

- Matja e pH
- Te tjera sipas standarteve teknike me te fundit.
- Ekzaminimet laboratorike per gjetjen e:
 - Mbetjeve
 - Mikroorganizmave patogjene
 - Kontaminuesit (ndotesit)
 - Prishje ose lloje te tjera te mbetjeve
- Per ekzaminimet laboratorike duhet bejre dallim midis dergesave ku rezultati eshte i pershtatshem ose jo per vendimin ne PIK:
 - Dergesat, per te cilat rezultati i kontrollit laboratorik percakton vendimin ne PIK, qendrojne te konfiskuar ne PIK apo ne nje zone te caktuar derisa rezultati te jete i disponueshem.
 - Dergesat e ekzaminuara ne kuadrin e nje programi ekzaminues do te lirohen pas marrjes se mostrave nese ajo ploteson te gjitha kerkesat e kontroleve te dokumentacionit, identitetit, fizik. Personeli i PIK-ut informon me faks apo e-mail rreth ekzaminimit Autoritetin Kompetent te Vendit te destinacionit.

3.5 TESTET LABORATORIKE TE PRODUKTEVE ME ORIGJINE SHTAZORE

Rregullat e meposhte duhet te aplikohen ne testet laboratorike te produkteve:

- A. P.I.K.-et duhet qe dergesat e produkteve per import t'i parashtroje ne nje plan monitorimi, me qellim monitorimin e pershtatjes me standartet nderkombetare ose rregullat kombetare kur ato aplikohen, dhe ne menyre te vecante per te zbuluar mbetjet, organizmat patogjene ose substanca te tjera te rrezikshme per njerezit, kafshet apo mjedisin. Keto plane monitoruese duhet te bazohen ne natyren e produkteve dhe ne riskun qe ato paraqesin duke marre parasysh te gjitha parametrat e monitorimit sic eshte frekuenca dhe numri i dergesave te ardhura dhe rezultatet e monitorimit te meparshem.
- B. Kur testet e rastit kryhen nen planin e monitorimit referuar ne paragrafin 1, dhe nuk ka dyshime per rrezik te menjehershme per shendetin publik dhe ate te kafsheve, dergesa e testuar mund te lihet e lire te levize perpara se te sigurohen rezultatet laboratorike. Ne te gjitha rastet DVIT qe shoqeron ngarkesen duhet jete i plotesuar perputhshmerisht dhe Autoriteti Kompetent i vendit te destinacionit njofton me shkrim pa vonesa me mjetet e sistemit te shkembimit te informacionit.
- C. Kur testet laboratorike kryhen ne baze te dyshimit te inteligjences ne dispozicion per parregullsi, , perfshire njoftime te meparshme nga nje organizate nderkombetare si (O.I.E., B.E., etj.) ose nje mase mbrojtese, dhe kur testimi ka lidhje me nje substance ose me nje agjent patogjen i cili shfaq rrezik te menjehershme direkt per shendetin publik dhe ate te kafsheve, veterineri zyrtar pergjegjes i PIK-ut, i cili kryen testimin ose Autoriteti Kompetent duhet te ndaloje dergesen ne hapesirat veterinare dhe ta liroje vetem kur te merren rezultate te kenaqshme te testeve laboratorike. Gjate kesaj kohe ngarkesa duhet te qendrojne nen kontrollin e autoriteteve dhe nen pergjegjesine e veterinerit zyrtar ose agjentit zyrtar te PIK-ut i cili ka kryer kontrollin veterinare.

3.6 MARRJA E MOSTRAVE

- Mostrat duhet te merren me kujdes me higjene personale te nevojshme dhe masa te sigurie. Per te shmangur kontaminimin duhet te perdoren vetem mjete ne gjendje te mire, duar gjithmone te lara me sapun dhe te dizinfektuara, ose perdorim i dorezave nje-perdorimshe.

3.6.1 Rregjistrimi i mostrave dhe plotesimi i dokumentit shoqerues

- Çdo moster duhet te regjistrohet ne nje baze te dhenash elektronike te PIK-ut ku eshte kryer marrja e mostrave.
- Dokumenti per mostren duhet te plortesohet teresisht ne nje kompjuter dhe te printohet. Ky dokument duhet te shoqeroje mostrat deri ne laborator.

3.6.2 Paketimi dhe Identifikimi

- Mostrat e marra duhet te paktohen ne qese te reja plastike dhe te kene te shenuar numrin e DVIT, numrin e dokumentit te vulosur te mostres.
- Mostrat qe kerkojne kushte ne temperatura te caktuara duhet te ruhen dhe transportohen nen keto kushte temperature.
- Mostrat qe nuk kerkojne kushte temperature mund te behen ne kuti te mbrojtura ose canta plastike.
- Paketimi i jashtem do te shenohet me nje shirit te plote dhe te dergohet ne laborator.

3.6.3 Transporti

Mostrat duhet te dergohen sa me shpejt te jete e mundur ne laborator. Gjate transportit mostrat duhet te ruhen nen kushtet e temperatures te kerkuara ne nje vend te vecante i posacem vetem per kete ruajtje nen mbikqyrje zyrtare. Nuk duhet te kete asnje moster te pa shenuar ose te panjhur ne PIK.

Me dorezimin e mostrave ne nje agjent te transportit do te leshohet modeli per moster te transportuar. Agjenti ne pritje firmos dokumentin.

3.6.4 Perpunimi i rezultateve te ekzaminimit laboratorik.

Pas marrjes se rezultateve laboratorike perfundimtare, veterineri zyrtar i dergon nje kopje pergjegjesit per ngarkesen.

- Rezultati duhet te regjistrohet ne bazen e te dhenave elektronike te PIK-ut.
- Vendimi mbi dergesen: nese dergesa i permbysh kerkesat, veterineri zyrtar njofton pergjegjesin e ngarkeses qe ngarkesa eshte e lire dhe leshon DVIT . Dergesat qe nuk permbushin kerkesat do te refuzohen per importim.
- Shqyrtimi: veterineri zyrtar informon me fax autoritet kompetente te vendit te destinacionit per rezultatet.
- Ne rast te nje rezultati te pafavorshem (kontrolli, vendim mbrojtës, plani monitorimi, shqyrtim i RASFF) te gjitha dokumentet e kerkuar duhet te dergohen me fax autoriteteve qendrore per masa te metejshme. Keto dokumenta jane: dokumenti shoqerues i mostres, rezultati laboratorik, DVIT, certifikata shendetesore dhe dokumenta te tjera qe sherbejne per marje vendim.
- Duhet te rregjistrohen te pakten te dhenat e meposhtme: numri DVIT, emir i PIK-ut, data e marrjes se mostres, data e rezultatit laboratorik, pershkrimi i produktit, emir i vendit te origjines, numri i certificates shendetesore, numri i stabilimentit te aprovuar (nese aplikohet), rezultati i kontrollit laboratorik me pershkrimin e substances se zbuluar dhe koncentrimi.
- Laboratori duhet te njoftoje rezultatet me Minimumin e Limiteve te Kerkuara (MLK) te vendosur (Vendimi 2005/34/KE).

3.6.5 Mbyllja e pakove dhe konteniereve te hapur, trajtimi i mostrave pas ekzaminimit.

Vetem pakot qe garantojne mos rrezikshmeri per zinxhirin ushqimor ose shendetin e kafsheve, pas hapjes dhe mbylljes ne PIK, do te mbyllen dhe dergohen mbrapsht tek ngarkesa.

- Pakot e hapura do te mbyllen dhe shenohen me nje etikete te inspektimit.
- Kontenieret e hapur do te vulosen. Te gjitha mallrat e tranzitit do te vulosen gjithashtu nga dogana.
- Numri i etiketes se inspektimit dhe vulosja duhet te regjistrohet ne model.
- Mostrat e ekzaminuara jane caktuar per tu shqyrtuar ne kategoria 2 te materialit (Rregullorja 1774/2002) dhe te percaktuara per shkaterrim.

KAPITULLI V

MARRJA E MOSTRAVE

Aneksi 1

Zgjerimi i marrjes se mostrave ne rast perjashtimesh.

Numri i mostrave per njesite e pakove < 1 kg peshe neto	
Njesi pako	Numri i mostrave
< 4800	13
4801 - 24000	21
24001 - 48000	29
48001 - 84000	48
84001 - 144000	84
144001 - 240000	126
≥ 240001	200

Numri i mostrave per njesi pako ≥ 1 kg. dhe < 4,5 kg peshe neto	
Peshe Neto	Numri i mostrave
< 2400	13
2401 - 15000	21
15001 - 24000	29
24001 - 42000	48
42001 - 72000	84
72001 - 120000	126
≥ 120001	200

Numri i mostrave per njesi pako ≥ 4,5 kg peshe neto	
Peshe Neto	Numri i mostrave
< 600	13
601 - 2000	21
2001 - 7200	29
7201 - 15000	48
15001 - 24000	84
24001 - 42000	126
≥ 42001	200

KAPITULLI VI

DOKUMENTI VETERINAR PER IMPORT DHE TRANZIT TE KAFSHEVE TE GJALLA NGA VENDET E TRETA NE SHQIPERI

Republika e Shqiperise

Dokumenti Veterinar per Import dhe Tranzitin e kafsheve te gjalla

Pjesa 1: Detaje te dergeses se paraqitur							
1. Derguesi/Eksportuesi Emri: Adresa:	2. Numri i references						
	3. Pika e Inspektimit Kufitar						
4. Marresi i ngarkeses Emri: Adresa:	5. Personi pergjegjes per dergesen Emri: Adresa:						
	6. Importuesi Emri: Adresa:	7. Vendi i origjines	8. Rajoni i origjines				
		9. Vendi i Destinacionit Emri: Adresa:					
10. Mberritja ne PIK (data parashikuar):							
11. Mjetet e transportit te identifikuara Emri i automjetit/Nr i fluturimit: Nr. fatures te shoqerimit / Nr. fatures ajrore: Nr. i vagonit/automjetit/trajlerit:	12. Dokumentat Veterinar Nr.: Data e leshimit: Dokumentat shoqerues:						
	13. Nr. i Plumbosjes						
14. Speciet e kafsheve/traca	15. Kodi i mallit/Kodi doganor						
	16. Numri i kafsheve:						
	17. Numri i pakove						
18. Kafshe te certifikuara per:							
Mbareshkrimin / Prodhimi	<input type="checkbox"/>	Per shendetesi	<input type="checkbox"/>	Therje	<input type="checkbox"/>	Kafshe shtepiake	<input type="checkbox"/>
Autoriteti miratues	<input type="checkbox"/>	Karantine	<input type="checkbox"/>	Cirk/ekspozim	<input type="checkbox"/>	Stafete	<input type="checkbox"/>
Te tjera	<input type="checkbox"/>						
19. Per tranzit ne nje Vend te Trete Vendi i Trete: PIK-u dales:							
20. Per ri-import Vendi nga ku ri-dergohet:							
21. Per import ose pranim							
Import perfundimtar			<input type="checkbox"/>				
Pranim i perkohshem			<input type="checkbox"/>				
Te tjera			<input type="checkbox"/>				

22. Deklarata Une, i nenshkruari personi pergjegjes per ngarkesen e pershkruar me lart, vertetoj mbi bazen e njohurive te mia me te mira dhe besimin qe deklarimet e bera ne Pjesen ite ketij dokumenti jane te verteta dhe te plota dhe jam dakort te permbush kerkesat e ligjit shqiptar.
23. Vendi dhe data e deklarimit
24. Emri i nenshkruarit
25. Firma

Republika e Shqiperise

Dokumenti Veterinar per Import dhe Tranzitet e kafsheve te gjalla

Part 2: Vendimi per dergesat e paraqitura			
26. Numri i references			
27. Kontrolli i dokumentacioni	I pranueshem	<input type="text"/>	Jo i pranueshem <input type="text"/>
28. Kontrolli i identitetit	I pranueshem	<input type="text"/>	Jo i pranueshem <input type="text"/>
29. Kontrolli fizik	I pranueshem	<input type="text"/>	Jo i pranueshem <input type="text"/>
30. Teste Laboratorike	Po <input type="text"/>	Testuar per: _____	Jo <input type="text"/>
31. Rezultatet e testeve	I pranueshem	<input type="text"/>	
	Jo i pranueshem	<input type="text"/>	
	Ngarkesa e leshuar ne pritje te nje rezultati	<input type="text"/>	
32. E pranueshme per	Tranzit <input type="text"/>	Vendi i Trete: _____	
	Trajtim te veçante (kanalizim i ngarkeses) <input type="text"/>	Ri-importet e kafsheve te gjalla shqiptare	<input type="text"/>
33. E pranueshme per import perfundimtar	<input type="text"/>		
34. E pranueshme per destinacion te kontrolluar	Therje <input type="text"/>	35. E papranueshme	Ri-shperdarje <input type="text"/>
	Trupat miratues <input type="text"/>		Therje <input type="text"/>
	Karantina <input type="text"/>		Eutanazi/Ngordhje <input type="text"/>

36. E pranueshme per kohe te caktuar <input type="checkbox"/> Afati i fundi _____	Qe nga data: _____			
